**Raport për Konsultimin Publik të Projektligjit**
**"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.163/2014 "Për urdhërin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar"**

| **Titulli i projekt-aktit** | **Afati i paraqitjes në KM** | **Objektivi/Qëllimi** | **Peridha e konsultimit publik** | **Mënyra e konsultimit publik** | **Komente** |
|---|---|---|---|---|---|
| Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.163/2014 "Për urdhërin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar" | Katërmujori II i vitit 2020 | Projektligji rregullon kriterin bazë të anëtarësimit dhe të liçensimit në Urdhërin e Punonjësit Social, kërkesë kjo e vazhdueshme e grupeve të interesit.<br><br>Qëllimi i projektaktit është rregullimi i profesionit e punonjësit social dhe do të garantojë cilësinë e shërbimeve në fushën e punës sociale, sidomos në atë të shërbimeve sociale.<br><br>Hartimi i këtij projektligji synon përmirësimin e kritereve të anëtarësimit në Urdhër duke arritur një përputhshmëri të plotë dhe me ligjet që rregullojnë | Sipas Parashikimeve Ligjore të ligjit 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik".<br><br>. | 1. Përmes Rregjistrit Elektronik për Njoftim dhe Konsultim Publik http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/261<br><br>2. Projektligji u diskutua në datën 11 shtator 2018 në tryezën me përfaqësuesit e departamente te Punonjësve Social. Prezantimi i ndryshimeve në Ligjin nr.163/2014 "Për urdhërin e | 1. Përmes Rregjistrit Elektronik, akti është postuar më datë 27.2.2020 dhe nuk kanë ardhur komente.<br>2. Në tyrezën e konsultimit u prezantua projektligji dhe risitë që sjell.<br>Pati sugjerime nga pjesmarrësit. Lidhur me Nenin Në nenin 14, ku shtohet si kriter në përzgjedhjen e kryetarit të urdhërit kriter "të kenë jo më pak se pesë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit të punonjësit social", nga një vit që është në ligjin ekzistues.<br><br>Gjithashtu është riformuluar neni 19 "Dispozitat kalimtare" ku përcaktohen kritere të veçanta për individët, që në |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | profesionet e tjera, si ai i psikologut. | | punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar"<br><br>Në këtë tryezë morën pjesë,<br>Znj. Bardhylka Kospiri, Zv/Ministre<br><br>Znj. Denada Seferi Drejtore e e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale<br>Përfaqësues të departamente te Punonjësve Social.<br><br>3. Takim të përbashkëta me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, datë 04.06.2020 | momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtrojnë ose kanë ushtruar profesionin e punonjësit social për një periudhë të gjatë (janë disa kategori të ndryshme), por nuk plotësojnë kriterin e vendosur në nenin 1 të këtij projektligji. Këta individë bëhen anëtarë të urdhrit të Punonjësit Social vetëm pas dhënies me sukses të provimit të shtetit.<br>3. Gjatë takimit me MASR janë dakortësuar disa çështje si ndryshimi i terminologjisë dhe ndryshime në teknikë legjislative.<br>Gjithashtu, me MASR është diskutuar dhe rishikimi i afateve lidhur me dispozitat kalimtare për individët që ushtrojnë profesionin e punonjësit social. |